

Erion ÇAKA – Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Trajtimit të Pronave

Z. Erion ÇAKA ka përfunduar studimet pranë Fakultetit të Drejtësisë në vitin 2007, si dhe mban titullin “Master i Shkencave në Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes Kombëtare/Ndërkombëtare, pranë Akademisë së Forcave të Armatosura.

Ai ka qenë pjesmarrës si ekspert në Konferenca të ndryshme Kombëtare e Ndërkombëtare në fushën e drejtësisë si dhe ka kryer një sërë kualifikimesh për Çështjet e Sigurisë Kombëtare dhe të Antikorrupsionit.

Z.ÇAKA gjatë karrierës së tij profesionale ka mbajtur disa pozicione të rëndësishme në Administratën Shqiptare pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në Drejtorinë e Hetimit dhe në Ministrinë e Drejtësisë, Drejtoria për Marrëdhëniet Juridiksionale dhe Bashkëpunimin Ndërgjyqësor.

Ai është njohës i mirë i gjuhëve të huaja si Anglisht dhe Italisht.

Prej Qershorit 2024, Z. Erion ÇAKA mban pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Trajtimit të Pronave.